



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
K R Y E T A R I

Nr.509/8 Prot.

Tiranë, më 20/09/2016

V E N D I M

Nr.108, Datë 20/09/2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË
PRRENJAS MBI PËRPUTHSHMËRINË E VEPRIMTARISË ME KRITERET DHE
KËRKESAT E KUADRIT RREGULLATOR NË FUQI

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Përrenjas me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi” për periudhën 01.07.2014 – 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar kërkesat e VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, mbi procedurat e transferimit të pronave në NJQV^{ve}.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas, të marrë masa për inventarizimin, evidentimin, vlerësimin dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer, u konstatua se, nuk ka funksionuar sektori i administrimit të pronave të bashkisë, si dhe nuk janë ngritur grupe pune për inventarizimin, evidentimin dhe regjistrimin e pronave të Bashkisë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652,

datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas, të miratojë strukturën e pronave publike dhe menaxhimit të aseteve, si dhe të ngrejë grupet e punës për të plotësuar me dokumentacionin e mjaftueshëm e të nevojshëm pronat e transferuara nga institucionet që i kanë pasur në inventar ato, me qëllim vlerësimin paraprak dhe regjistrimet në kontabilitet, në përputhje me pikën 22, të VKM^{së} nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, të ish-Komunave Rrajcë, dhe Qukës, u konstatua se kryejnë aktivitet shfrytëzim karriere 11 subjekte, të cilët kanë në përdorim sipërfaqe pyjore/kullosore të shfrytëzueshme, gjithsej prej 424.39 ha. Për këto subjekte nuk janë lidhur kontrata qiraje për sipërfaqet që ato kanë në përdorim, për llogaritjen dhe pagesën e qirasë, sipërfaqe të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi/përdorim të këtyre Njësive Vendore, duke sjellë një mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetet e tyre për vlerën 383,746,864 lekë, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9791, datë 23.07.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar me ligjin nr. 9533, datë 15.05.2006, neni 38, germa “q” dhe nenin 40/1-Vlerësimi i dëmit, pika 1 dhe 2, VKM nr. 22, datë 09.01.2008” Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pika 4,6 dhe 11, VKM nr, 391, datë 21.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja 2, si dhe me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas në bashkëpunim Njësitë Administrative Qukës, Rrajcë dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke lidhur kontrata qiraje, para noterit publik, në përputhje me nenin 39 germa f, nenet 40, 54, 56, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe pikat 3, 4, 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, të ndryshuar, duke përcaktuar dhe arkëtuar detyrimet për qiranë në vlerën **383,746,864 lekë**, respektivisht:

- Subjekti “ [REDAKTUAR] ” shpk për sipërfaqen 25.4 ha me vlerë 13,581,334 lekë ,
- Subjekti “ [REDAKTUAR] ” shpk për sipërfaqe n 51.95 ha me vlerë 45,716,000 lekë,
- Subjekti “ [REDAKTUAR] ” shpk për sipërfaqen 166 ha me vlerë 146,080,000 lekë,
- Subjekti “ [REDAKTUAR] ” shpk për sipërfaqen 3.2 ha me vlerën 2,816,000 lekë,
- Subjekti “ [REDAKTUAR] ” shpk për sipërfaqen 30 ha me vlerën 26,400,000 lekë,
- Subjekti “ [REDAKTUAR] ” shpk për sipërfaqen 130.4 ha me vlerën 114,752,000 lekë,
- Subjekti “ [REDAKTUAR] ” shpk për sipërfaqen 3.3 ha me vlerën 2,299,000 lekë,
- Subjekti “ [REDAKTUAR] ” shpk për sipërfaqen 2.6 ha me vlerën 1,144,000 lekë,
- Subjekti “ [REDAKTUAR] ” shpk për sipërfaqen 23 ha me vlerën 20,240,000 lekë,
- Subjekti “ [REDAKTUAR] ” shpk për sipërfaqen 12.4 ha me vlerën 9,093,330 lekë,
- Subjekti “ [REDAKTUAR] ” shpk për sipërfaqen 1.54 ha me vlerën 1,355,200 lekë

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pikën 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, pikat 3, 7, 9, 10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor”.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas t’i kërkojë Ministrisë Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave, Ministrisë Energjetikës dhe Industrisë, që të marrë masa për evidentimin e

sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjorë dhe kulloror këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura. Gjithashtu për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimin e veprimtarisë të Kompanive minerare private, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Përrenjas dhe 3 Njësitë Administrative në juridiksion të saj, u konstatua se në fund të vitit 2015 janë 53 subjekte debitorë të biznesit të madh e të vogël, të cilët nuk kanë shlyer taksat dhe tarifet vendore për shumën 2,565,090 lekë. Për vjeljen e këtyre debitorëve Zyra e Taksave Vendore nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e debitorëve, në kundërshtim me nenin 34, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenit 12, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve, dhe nenit 91, të ligjit nr 9920 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar.

5.1. Rekomandimi: Për arkëtimin e detyrimeve tatimore nga 53 subjekte debitorë në shumën 2,565,090 lekë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të nxirren njoftim vlerësimit tatimore dhe të merren masat shtrënguese si më poshtë:

a-Tu dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP Librazhd (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”.

c-Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore “ të ndryshuar, me ligjin nr.164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

d-Në rast se Bizneset private edhe pas dërgimit të urdhër bllokimeve në Bankë dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Përrenjas dhe 3 Njësitë Administrative të kësaj Bashkie deri me datë 31.12.2015, nuk janë mbledhur debitorët familjarë për taksat e tarifet vendore në vlerën 15,811 mijë lekë, nga e cila 3292 familje për 10 vjet nga viti 2006-2015 taksë toke në vlerën 6,294 mijë lekë, tarifë uji i pijshëm 2021 familje në vlerën 5,369 mijë lekë, taksë ndërtese e tarifa të tjera vendore 3589 familje për vlerën 4,148 mijë lekë.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria që përgjigjet për Taksat Vendore, Bashkia Përrenjas, të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të marrë masa për arkëtimin e taksave e tarifave me vlerë 15,811 mijë lekë, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, në zbatim të pikës 71, të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 1, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e Buxhetit të Vitit 2016”, duke dërguar njoftim vlerësimit abonentëve familjarë me anë të Zyrës Postare, në Bashkinë Përrenjas dhe 3 Njësitë Administrative si më poshtë:

-*Bashkia Përrenjas*, për taksë toke për 246 familje në vlerën 749 mijë lekë, taksë ndërtese për 897 familje në vlerën 550 mijë lekë, tarifa vendore në 747 familje në vlerën 2,260 mijë lekë dhe tarifë uji i pijshëm në 223 familje me vlerën 623 mijë lekë.

-*Njësia Administrative Qukës*, për taksë toke për 941 familje në vlerën 1,970 mijë lekë, taksë ndërtese për 800 familje në vlerën 423 mijë lekë dhe tarifë uji i pijshëm për 624 familje në vlerën 1,083 mijë lekë.

-*Njësia Administrative Stravaj*, për taksë toke për 778 familje në vlerën 560 mijë lekë dhe tarifë uji i pijshëm për 200 familje në vlerën 234 mijë lekë.

-Njësia Administrative Rrajcë, për taksë toke për 1327 familje në vlerën 3,015 mijë lekë , taksë ndërtese për 1145 familje për vlerën 916 mijë lekë dhe tarifë uji i pijshëm për 1004 familje në vlerën 3,428 mijë lekë.

Menjëherë

7. Gjetjet nga auditimi: Në Bashkinë Prrenjas , në ish komunën Stravaj dhe ish Komunën Qukës, kanë ushtruar aktivitetet pa qenë të regjistruar 45 subjekte. Mos regjistrimi i këtyre subjekteve në QKR, ka sjellë mos llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimeve për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në vlerën 4,565,976 lekë, veprime në kundërshtim me nenet 40 dhe 41, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore”, i ndryshuar.

7.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan dhe ti kërkojë për regjistrimin e 38 subjekteve në QKR me qëllim arkëtimin e detyrimeve të Kontributeve për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore me vlerën prej **4,565,976 lekë**, të cilët kanë ushtruar aktivitetet të pa licencuar.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e menaxhimit të pronave të paluajtshme të Bashkisë Përrenjas, u konstatua se në pronat e regjistruar në ZVRPP me NP. 537/74 me emërtimin “truall” me sipërfaqe 26435 m², vol 9, fq 197, datë 11.01.2011 dhe nr. 269, me NP. 28/2 me emërtimin “arë” me sipërfaqe 3950 m², vol 7, fq 56, datë 29.9.2009 dhe nr. 4816 dhe NP. 24 me emërtimin “arë” me sipërfaqe 2900 m², vol 7, fq 53, datë 29.9.2009 dhe nr. 4815; përdoren nga individë të ndryshëm pa lidhur kontratë qiraje, duke sjellë një mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë për vlerën 63,452,220 lekë, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, ku në kreun III, pika 1, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre asetëve, si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore të cilat kanë sjellë keqadministrimin e tyre, në bazë të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, me ndryshime .

8.1. Rekomandimi: Bashkia Prrenjas, të marrë masa për lidhjen e kontratave me personat të cilët i kanë zënë këto prona, para noterit publik, në përputhje me nenin 39 germa f, nenet 40, 54, 56, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe pikat 3, 4, 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, të ndryshuar, duke përcaktuar dhe arkëtuar detyrimet për qiranë në vlerën **63,452,220 lekë**.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga sektori i Financës së Bashkisë Përrenjas nuk janë plotësuar ditari i veprimeve të ndryshme për mbylljen e llogarive në fund të viteve ushtrimore, ditari i shpenzimeve të thesarit dhe libri përmbledhës i llogarive. Pozicionet financiare të paraqitura në bilancet e viteve 2014 e 2015, janë plotësuar të pambështetura në të dhënat e kontabilitetit, veprime këto në kundërshtim me ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligji nr. 10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, neni 5 dhe UMF nr. 26, datë, 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre”.

9.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë të merren masa për plotësimin e ditarëve të kontabilitetit: Ditari i shpenzimeve të thesarit, ditari i veprimeve të ndryshme dhe libri përmbledhës i llogarive (centralizatori ose libri i madh).

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e pasqyrave financiare u gjetën të plotësuara gabim : Pasqyra e shpenzimeve për investime pasi në bilancin e vitit 2014 janë paraqitur si shpenzime të pa mbyllura për investime në formatin nr. 4, “Burimet dhe shpenzimet në lidhje me investimet në rreshtat nr. 36, 38, 39, 40, 41 e 44. Teprica e kësaj pasqyre që duhet të jetë e barabartë me pozicionin financiar të rreshtit 20, të formatit nr. 1, por në fakt kjo llogari prej vitesh është paraqitur pa gjendje, në kundërshtim me UMF nr. 26 datë, 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe

raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre” i ndryshuar. Gabimi është për vitin 2014 në vlerën 11,854,450 lekë, ndërsa për vitin 2015 është 47,036,715 lekë.

10.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë të merren masa për sistemimin e veprimit kontabël duke i mbyllur shpenzimet për investime për sa mbahen të pa mbyllura në bilancin e vitit 2015, sipas nr. Formati nr. 4 “Shpenzime për investime” në shumën 47,036,715 lekë.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në llogarinë nr. 467 ”Kreditorë të ndryshëm”, me pozicion financiar në bilancin e vitit 2015 me vlerën 47,036,715 lekë, nuk ka analizë të trashëguar prej vitesh si dhe asnjë dokumentacion tjetër mbështetës në kundërshtim me UMF nr. 26 datë, 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre” i ndryshuar.

11.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë të merren masa për sigurimin e analizës të llogarisë nr. 467 ”Kreditorë të tjerë” e paraqitur në bilancin e vitit 2015, në vlerën 47,036,715 lekë, në të kundërt nëse detyrimet nuk pasqyrohen me dokumentacion mbështetës të sistemohet me veprim kontabël duke marrë miratimin e Nëpunësit Autorizues.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Në bilancin e vitit 2015, formulari nr. 6, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (vlera bruto)”, për sa janë shkarkuar nga kontabiliteti i vitit 2015, në kolonën ”Nxjerrje jashtë përdorimit”, përkatësisht: Në llogarinë nr. 214 ”Instalime teknike, makineri e pajisje në vlerën **2,354,275 lekë** dhe në llogarinë nr. 218 ”Inventarë ekonomik në vlerën 2,117,015 lekë, pa u mbajtur proces verbalet e asgjësimit dhe pa u miratuar në Këshillin Bashkiak, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.11.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

12.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë të merren masa për sistemimin e veprimit kontabël për shkarkimin e inventarëve në debi të llogarisë nr. 24 “Aktive të qëndrueshëm të trupëzuara të dëmtuara” respektivisht vlerat sipas llogarive nr. 214 ”Instalime teknike, makineri e pajisje në vlerën 2,354,275 lekë dhe në llogarinë nr. 218 ”Inventarë ekonomik në vlerën 2,117,015 lekë dhe kontabilizimin e shkarkimit sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak të vitit 2016.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2015 nuk është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi sipas kërkesave të pikës 99, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.11.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pasi në Urdhrin nr. 991, datë 15.10.2015 “Për inventarizimin e materialeve të institucioneve në vartësi të saj, njësite administrative dhe të Bashkisë Përrenjas”, jo vetëm janë përdorur dispozita të shfuqizuara por nuk është caktuar Nëpunësi Zbatues në krye të komisionit të inventarit dhe të vlerësimit për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve të qëndrueshme. Për çdo njësi administrative janë ngritur komisione të veçanta për inventarizim dhe nuk janë dorëzuar inventarët e njësite administrative në bashki dhe as është kuadruar përmbledhësja e inventarit fizik me të dhënat e kontabilitetit.

13.1. Rekomandimi: Nga Kryetare e Bashkisë Përrenjas, në cilësinë e Nëpunëses Autorizuese të merren masa për rishikimin e inventarizimit të pasurisë dhe të rakordimit të gjendjes kontabile me gjendjen fizike.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Në bilancin përmbledhës të vitit 2015 (Përfshirë dhe aktivitetin e ish-Komunave për 6/mujorin e parë 2015), nuk është punuar sipas kërkesave të VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ”Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, te prekura nga riorganizimi administrativo territorial”. Nuk ka funksionuar grupi i punës i ngritur sipas Urdhrit nr. 362/1, datë 29.06.2015 (i përbërë nga J.A. juriste, J.Zh. inspektore buxheti, B.K. inspektore buxheti, M.J. specialiste arkiv protokollit me objekt: “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 44 ”Për kompetencat e kryetarit” si dhe në mbështetje të VKM nr. 510, datë 10.06.2015, ”Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe

detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar ne njësitë e qeverisjes vendore, te prekura nga riorganizimi administrativo territorial”. Gjithashtu është larguar nga detyra ish-përgjegjësi i sektorit të financës pa e dorëzuar detyrën me shkrim deri në datën e largimit nga puna 21.09.2015. Sa sipër është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3237, datë 16.07. 2015 të dy ministrive: Ministri për Çështjet Vendore dhe Ministri i Financave “Për procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial, pika 2, germa (a) dhe germa(b). Gjithashtu në pikën 4, është përcaktuar se: Në përbërje të grupit të punës duhet të jetë të paktën: Punonjësi më i lartë i financës, por në fakt është caktuar ekonomiste pa përvojën e duhur (nuk ka mbyllur asnjëherë bilanc).

14.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Përrenjas të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat për rishikimin e bilancit të punës për administrimin dhe arkivimin e të gjithë dokumentacionit ligjor (të pa grumbulluar) nga njësitë administrative që i përkasin reformës administrative të vitit 2015, duke përcaktuar detyra konkrete për çdo drejtori dhe sektor.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Prej vitesh nuk ka kuadruar inventari fizik i shkollave që administrohen nga bashkia, pasi furnizimet e bëra nga Zyra Arsimore Librazhd, Drejtoria Rajonale Arsimore Elbasan, Ministria e Arsimit, në adresë të shkollave që ka në administrim Bashkia Përrenjas, nuk bëhen hyrje në magazinën e bashkisë. Si pasojë e moskryerjes së këtij veprimi, bashkia nuk disponon inventarin kontabël sipas shkollave dhe rrjedhimisht dhe inventari fizik është i pa bazuar ligjërisht (i pasaktë), nuk ka bazë krahasuese.

15.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Përrenjas të merren masa për rakordimin me Zyrën e Arsimore Librazhd për furnizimet që i janë bërë shkollave nga Zyra Arsimore Librazhd që janë në juridiksionin e bashkisë dhe të sistemohet inventari kontabël sipas shkollave duke nxjerrë përgjegjësinë materiale nga krahasimi i gjendjes kontabël me gjendjen fizike të inventarëve nëpër shkolla.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron projekt buxhetet e paraqitura për miratim në Këshillin e Bashkisë u konstatua se nuk janë zbatuar plotësisht Udhëzimet e Ministrisë Financave, pasi mbi bazën e metodologjisë së planifikimit dhe eksperiencës së trashëguar nuk janë përlllogaritur detyrimet afat shkurtër të pritshme dhe të rezultuara në mbyllje të viteve të mëparshme për detyrimet e të tretëve ndaj bashkisë dhe detyrimet e bashkisë ndaj të tretëve. Për vitin 2015 programimi i buxhetit është miratuar jashtë afatit, pasi duhej të ishte bërë programimi brenda vitit 2014. Rakordimi i bashkisë me Degën e Thesarit Librazhd është bërë në mënyrë të njëanshme pasi nuk është mbajtur ditari i shpenzimeve të thesarit me artikuj dhe nën artikuj dhe kontabiliteti i shpenzimeve të thesarit nuk ka as një garanci (kredit i llogarisë nr.520 “Disponibilitete në thesar).

Nuk ka funksionuar grupi i punës i ngritur sipas urdhrit nr. 362/1, datë 29.06.2015 me objekt:” Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 44, ”Për kompetencat kryetarit si dhe në mbështetje të VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ”Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar ne njësitë e qeverisjes vendore te prekura nga riorganizimi administrativo territorial”. Është vepruar në kundërshtim me nenin 6 dhe 7 ”Menaxhimi dhe kontrolli Financiar” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor”. Nga grupi i punës i ngritur sipas urdhrit nr. 362/1, datë 29.06.2015, nuk disponohet asnjë material përmbledhës për punën që ka kryer ky grup pune pasi ka mangësi në kuadrin e realizimit të buxhetit me të dhënat e bilancit të vitit 2015, në grumbullimin dhe administrimin e dokumentacionit të njërive të shkrira nga reforma administrative. Në grupin e punës nuk është përfshirë Përgjegjësi i Sektorit të Financës, por është përfshirë në grupin e punës ekonomiste pa eksperiencën e duhur (nuk ka mbyllur asnjëherë bilanc).

16.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Përrenjas të merren masa për analizimin e treguesve të buxhetit të 6-mujorit të vitit 2016, duke pasqyruar detyrimet ndaj të tretëve dhe treguesit e pritshëm për të ardhurat dhe shpenzimet që i përkasin vitit 2016. Të analizohen faktorët ndikues

në disbalancimin e buxhetit të bashkisë, i trashëguar nga viti 2014 e në vazhdim. Gjithashtu të merren masa për hartimin e PBA duke ngritur grupet e posaçme të punës brenda afateve ligjore.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nuk është grumbulluar dokumentacioni nga njësitë administrative, Rajcë, Stravaj dhe Qukës që i përket aktivitetit të Policisë Ish-Komunave të shkrira, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo territorial". Nuk u vu në dispozicion të auditimit asnjë dokumentacion mbi veprimtarin e policisë së ish-Komunave Rajcë, Stravaj e Qukës, sot (Njësi administrative), që i përkasin periudhës deri datë 30.06.2015. Konstatohet se nuk ka funksionuar komisioni i ngritur sipas Urdhrit nr. 362/1, datë 29.06.2015.

17.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Përrenjas të merren masa për grumbullimin e dokumentacionit të aktivitetit të Policisë që administrohet nga Njësitë Administrative Rajcë, Stravaj e Qukës. Njëkohësisht, Policia Bashkiake të hartoj dokumentacionin e nevojshëm si librin e shërbimit, pajisjen me bllok gjobash dhe raportimin me shkrim për zbatimin e urdhrave të nxjerrë nga titullari i bashkisë.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga inspektorët aktual të IMTV nuk është marrë në dorëzim detyra me proces verbal në lidhje me dokumentacionin e trashëguar nga ish-inspektorët si dhe nuk është marrë detyra me proces verbal në lidhje me dokumentacionin e trashëguar nga ish-komunat, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo territorial". Nuk administrohen gjocat e vëna në ish-Komunat (njësitë administrative) Qukës, Stravaj e Rajcë.

18.1. Rekomandimi: Nga Bashkia të merren masa për grumbullimin e dokumentacionit që disponohet në Njësitë Administrative që i përkasin aktivitetit të IMTV, si dokumentacion i nevojshëm për efektivitetin e punës së këtij inspektorati që mbulon gjithë territorin e Bashkisë Përrenjas.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Dosjet teknike të investimeve të cilat u audituan rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", pika 4, paragrafi 4.

19.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Përrenjas, nga auditimi i mëparshëm, janë rekomanduar nga KLSH detyra për tu zbatuar sipas shkresës me nr. 613/9, datë 30.09.2014. Zbatimi i këtyre rekomandimeve, është audituar sipas programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1128/2, datë 3.12.2014 për të cilin është mbajtur akti i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve nr. 1, datë 29.12.2014. Me shkresën nr. 1188/77, datë 27.03.2015 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve të pazbatuara ose në proces zbatimi.

-Nga 3 masa organizative me vlerë 5,867,029 lekë, nuk kanë gjetur zbatim të plotë ose zbatuar pjesërisht 3 masa me vlerë 4,083,704 lekë. Nga këto: Vlera prej 5,658,429 lekë detyrim i ri kërkuar për taksën e ndikimit në infrastrukturë, janë arkëtuar 1,585,025 lekë dhe ka mbetur pa u arkëtuar vlera prej 4,073,404 lekë; nga vlera e ri kërkuar për arkëtim për taksën e tokës prej 208,600 lekë është arkëtuar vlera prej 198,300 lekë dhe ka mbetur pa arkëtuar vlera prej 10,300 lekë. Në lidhje me anulimin e 2 lejeve të ndërtimit nuk është ndërmarrë asnjë veprim për anulimin e tyre.

-Nga 4 masa shpërblim dëmi me vlerë 5,789,895 lekë, nuk kanë gjetur zbatim 4 masa me vlerë 5,789,895 lekë. Janë ndjekur procedurat administrative për arkëtimin e dëmit; titullari i bashkisë

nuk ka nxjerrë urdhrat e zhdëmtimit, por ka bërë njoftimet subjekteve debitore. Në 3 masa për 3 subjekte nuk kanë vazhduar pagesat për fatura të paraqitura si dhe nuk është bërë kthimi i garancisë së punimeve për shuma që përfshijnë shumat debitore të këtyre subjekteve. Këto subjekte as e kanë pranuar detyrimin as kanë bërë padi në Gjykatë, po as nga Bashkia Përrenjas nuk janë bërë kërkesë padi në Gjykatë ndaj subjekteve debitore për arkëtimin e vlerës së dëmit.

20.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Përrenjas të merren masat e nevojshme administrative dhe ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të rekomanduara dhe të ri kërkuara me shkresën nr. 1188/77, datë 27.03.2015, për zbatimin e tyre të njoftohet me shkrim brenda afatit ligjor Kontrollit i Lartë i Shtetit.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se për periudhën objekt auditimi është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), por nuk ka funksionuar. Nga auditimi mbi sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm rezultoi se veprimtaria e administratës së bashkisë nuk mbështetet në strategji zhvillimi afat mesme dhe vjetore si dhe nuk ka programuar dhe miratuar objektiva strategjik por i kryen aktivitetet me plane pune periodike për realizimin e misionit të ngarkuar me ligjin për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor. Në këto kushte edhe vlerësimi dhe menaxhimi i riskut në mungesë të objektivave kryhet i pjesshëm dhe në shumë raste formal sa për të plotësuar kërkesat e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, funksionimi i administratës së bashkisë, përfshi 3 ish-komuna në strukturë, Njësi Administrative të Bashkisë, mbështetet ende në rregulloren ekzistuese si dhe nuk ka gjetur zbatim ligji për statusin e nëpunësit civil. Menaxhimi i burimeve njerëzore është në nivele të ulëta, regjistri i personelit nuk është azhurnuar prej vitesh dhe nuk ndiqet asnjë lloj procedure për rekrutimin e punonjësve, nuk kryhet vlerësimi periodik si dhe nuk janë parashikuar në asnjë akt masat disiplinore dhe procedurat e dhënies së tyre për punonjësit në veprimtarinë e përditshme. Në këto kushte në mbyllje të aktivitetit vjetor të Bashkisë hartimi i deklaratës së cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raportit vjetor për funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe pyetësorit të vetëvlerësimit të komponentëve të MFK janë të mangëta dhe nuk pasqyrojnë me vërtetësi realitetin e vlerësimit të gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

21.1. Rekomandimi: Të merren masa nga Kryetarja e Bashkisë për të ngritur një grup pune me drejtues dhe specialistë, me një program të mirë përcaktuar pune, për vlerësimin e situatës aktuale, përfshi dhe njësitë administrative, dhe të përgatisin mbi bazën e konkluzioneve, strategjinë afatmesme dhe atë vjetore të bashkisë me qëllim përcaktimin sa më real të objektivave që duhet të arrijë Bashkia Përrenjas si dhe planet periodike të veprimit për përmbushjen e objektivave si dhe përshtatjen e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të bashkisë për të përfshirë në përcaktimet e saj veprimtarinë e njërive administrative. Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për implementimin e ligjit për statusin e nëpunësit civil në administratën e Bashkisë, Përrenjas. Gjithashtu të merren masa të menjëhershme nga Bashkia Përrenjas për njohjen nga menaxheri dhe stafi drejtues të MFK dhe komponentëve të tij, për ngritjen e një sistemi të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe përcaktim të metodologjisë për zbatimin e tij, për hartimin e një plan-veprimi konkret, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë identifikimin dhe menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të vëna në dispozicion rezulton se nuk janë respektuar kërkesat e ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", (ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010), Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB), miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.69, datë 29.09.2010 në lidhje me:

- realizimin e planit vjetor i auditimit sipas llojeve dhe objekteve të përcaktuara, ku për vitin 2014 nga 13 auditime janë realizuar 4 auditime ose në masën 30% dhe për vitin 2015 nga 14

auditime janë realizuar 6 auditime ose në masën 43%;- mos planifikimin dhe mosrealizimin e një mision auditimi për zbatim rekomandimesh për subjektet e audituara, të përcaktuara këto sipas prioriteteve dhe afateve kohore;- mungesën e deklaratave të pavarësisë, të takimit prezantues dhe përmbyllës, të pyetësorëve dhe letrave të punës si dhe të inventarit të dosjes dhe kostos së auditimit;- mosplotësimin e formatit të riskut, si pjesë e programit të angazhimit të auditimit;- të mos mbajtjes në asnjë rast të akteve të konstatimit për shkeljet e trajtuara me personat përgjegjës;- kapërcimi i fazës së dërgimit të Raportit Përfundimtar pranë subjektit të audituar, në të gjitha rastet e auditimeve;-mos detajimin e detyrave të lëna në mënyrë konkrete për çdo rekomandim në Raportet e finale;- në raportet finale janë dhënë vetëm rekomandime për masa organizative për gjetjet e trajtuara në raport, ndërsa për shkeljet me pasojë dëm ekonomik nuk janë rekomanduar masa për shpërbllim dëmi si dhe nuk janë rekomanduar masa administrative e disiplinore për punonjësit përgjegjës;- mos hartimin nga Përgjegjësi i Auditimit të Brendshëm i memorandumit të auditimit, i cili të përmbajë rekomandimet;- mungesën e vendimit të Titullarit për miratimin e raportit final dhe memorandumit. –mos realizimin e auditimeve të thelluara në disa drejtime të tilla që mbartin në vete rrisht të lartë si mbajtja e kontabilitetit, hartimi i pasqyrave financiare, inventarizimi i aktiveve dhe procedurat e prokurimit me vlerë të lartë për investimet. Po kështu është lënë jashtë auditimit administrimi dhe menaxhimi i aseteve.

22.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Përrenjas të merren masa që Zyra e Auditimit të jetë efiçente dhe të zbatojë standardet e auditimit në organizimin dhe funksionimin e saj në të gjitha fazat e procesit të auditimi dhe të sigurojë paraqitjen në mënyrë periodike para menaxhimit dhe Këshillit Bashkiak të raporteve të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditimit, në mënyrë që të realizojë misionin e saj, ku veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari e pavarur, që mbështet menaxhimin e njësisë vendore për arritjen objektive, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2014-31.12.2015 në bazë të strukturave organike të miratuara për vitet përkatëse dhe urdhrave të titullarit janë rekrutuar dhe bërë pagesa për çdo muaj për punonjës shërbimi me kontratë të përkohshme në një total prej 6,528,748 lekë, ku për Bashkinë Përrenjas 11 punonjës në shumën 980,000 lekë, për ish-Komunën Qukës 13 punonjës në shumën 3,684,300 lekë, për ish-Komunën Rrajcë 2 punonjës në shumën 604,850 lekë, për Ish-Komunën Stravaj 5 punonjës në shumën 1,259,598 lekë. Niveli i pagesës është nën nivelin e pagës minimale prej 22,000 lekë (të përcaktuar në sipas VKM nr. 573, datë 3.7.2013) dhe është përballuar nga fondet e zërit të shpenzimeve të buxhetit art.602 “shpenzime operative”. Për këto punonjës nga punëdhënësi është ndalur dhe derdhur tatimi në burim, por nuk janë ndalur dhe derdhur kontributet shoqërore dhe shëndetësore, për arsye të nivelit të pagës. Punësimi i këtyre punonjësve në këtë formë pa i deklaruar ato në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, duke iu shmangur detyrimeve të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore është në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar me ligjin nr. 10070 datë 5.2.2009 neni 13 pika 2 “Detyrimi për të paguar kontributet”, neni 79 “Detyrimet e punëdhënësit dhe të të vetë punësuarit”, i ndryshuar me ligjin nr. 104/2014 datë 31.07.2014 neni 10, dhe kanë shkaktuar **të ardhura të munguara në shumën 2,768,376 lekë për buxhetin e shtetit** (për vitin 2014 në shumën 1,688,088 lekë dhe për vitin 2015 në shumën 1,080,288 lekë).

23.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Përrenjas të merren masa që marrja në punë e punonjësve me kontratë të përkohshme të bëhet sipas kërkesave ligjore duke i deklaruar në organet tatimore, niveli i pagës të jetë në dhe mbi nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi, si dhe të bëhen pagesat përkatëse të detyrimeve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore nga punëdhënësi dhe punëmarrësi për çdo punonjës të rekrutuar.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Përrenjas nuk është mbajtur libri inventar me të dhënat e aktiveve të trupëzuara me azhurnimet e përditësuara deri në momentin aktual, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për

kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, kap, III pika 30.

24.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës të krijohet dhe të mbahet regjistri i aktiveve, i cili të hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit, ku të përfshijë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes deri në daljen e tij jashtë përdorimi.

Menjëherë

B1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Bashkia Përrenjas, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **21,933,662 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Përrenjas, u konstatua se kanë ushtruar aktivitet të paregjistruar në QKR 11 subjekte, të cilët kanë shmangur pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 212,917 lekë, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me pikën 1 e nenit 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", i ndryshuar, dhe pikat 1,2,3,4 dhe 5 e nenit 41, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

1.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit për 11 subjektet, sipas aneksit nr. 2 të Raportit Përfundimtar, të paregjistruara në QKR, **për vlerën 212,917 lekë**.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ish Komuna Qukës (sot Njësia Administrative Qukës), u konstatua se, kanë ushtruar aktivitet të paregjistruar në QKR 16 subjekte, të cilët kanë shmangur pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, në vlerën 339,400 lekë, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me pikën 1 e nenit 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", i ndryshuar, dhe pikat 1,2,3,4 dhe 5 e nenit 41, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

2.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas nëpërmjet Njesisë Administrative Qukës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit për 16 subjektet, sipas aneksit nr. 3 të Raportit Përfundimtar, të paregjistruara në QKR, **për vlerën 339,400 lekë**.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ish Komuna Stravaj (sot Njësia Administrative Stravaj), u konstatua se, kanë ushtruar aktivitet të paregjistruar në QKR 9 subjekte, të cilët kanë shmangur pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, në vlerën 96,800 lekë, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me pikën 1 e nenit 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", i ndryshuar, dhe pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 e nenit 41, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

3.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas nëpërmjet Njesisë Administrative Stravaj, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit për 9 subjektet sipas aneksit nr. 4 të paregjistruara në QKR, **për vlerën 96,800 lekë**.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Përrenjas, për pronat e regjistruara në ZVRPP me NP. 5/21+1-10 me emërtimin “apartament” me sipërfaqe 65.33 m², që administrohet nga z. B.B. nuk është lidhur kontratë qiraje me bashkinë duke shkaktuar dëm në vlerën 93,100 lekë, prona NP. 5/21 me emërtimin “apartament” me sipërfaqe 60.54 m² që administrohet nga z. Sh.H. nuk është lidhur kontratë qiraje me bashkinë duke shkaktuar dëm në vlerën 86,260 lekë dhe prona NP/2/430 me emërtimin “Kinoklubi i qytetit” me sipërfaqe 493 m², nga e cila sipërfaqja prej 32.6 m², përdoret nga H.Z. për aktivitet bar kafe për pensionistët, nuk është lidhur kontratë qiraje për sipërfaqen të cilën e përdor, duke shkaktuar dëm për vlerën 78,240 lekë, gjithsej vlera e dëmit të shkaktuar nga mos lidhja e kontratave është në vlerën 257,600 lekë, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, ku në kreun III, pika 1, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore të cilat kanë sjellë keqadministrim e tyre, në bazë të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, me ndryshime.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas, të lidhë menjëherë kontratat e qirasë me personat të cilët i përdorin këto prona e të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar **shpërblimin e dëmit në vlerën 257,600 lekë**, nga B.B. për vlerën 93,100 lekë, Sh.H. në vlerën 86,260 lekë dhe H.Z. në vlerën 78,240 lekë.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Përrenjas, me VKB nr. 51, datë 23.12.2010, nr. 46, datë 05.12.2012 dhe nr. 26, datë 10.07.2012 “Për ndarjen e objekteve shtetërore pronë e Bashkisë Përrenjas për banesa familjare” ka vendosur të japë objektet për fond banese: -“Ish konvikti 3kt “Shkolla e mesme Gjeologji-Miniera Përrenjas”, me sipërfaqe 722 m², -“Ish zyrat e ndërmarrjes së kromit Përrenjas” me sipërfaqe 300 m², “Ish laboratorit i ndërmarrjes së kromit Përrenjas” me sipërfaqe 180 m², “Ish klinika dentare Përrenjas” me sipërfaqe 618 m² dhe “Ish shtëpia e pionierit Përrenjas”, me sipërfaqe 120 m², për këto prona të ndara sipas VKB për banorë të Bashkisë Përrenjas, nuk janë lidhur kontrata qiraje në referencë të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, ku në kreun III, pika 1, germa “a” tarifa është jo më pak se 100 lekë/m²/muaj, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, nga mos lidhja e kontratave të qirasë për këto objekte, është shkaktuar buxhetit të Bashkisë dëm në vlerën 5,710,640 lekë.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas, të lidhë menjëherë kontratat e qirasë me personat të cilët i përdorin këto prona e të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit **në vlerën 5,710,640 lekë**, sipas aneksit 5 të Raportit Përfundimtar.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Rrajcë ka lidhur 2 kontrata për sipërfaqe pyjore/kullosore, të cilat shfrytëzohen nga subjektet private. Tarifa e qirasë së këtyre kontratave nuk është përcaktuar sipas VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave” lidhja 2, duke mos llogaritur diferencën në vlerën 4,243,600 lekë, me dëm ekonomik në buxhet, konkretisht:

- “[REDACTED]” shpk me administrator F.K. ka lidhur kontratë qiraje nr. 156. prot., datë 13.02.2014 pa noter, me ish-Komunën Rrajcë për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik prej 34000 m², me vlerë qiraje të pa llogaritur për vlerën 1,509,600 lekë.

-“[REDACTED]” shpk me përfaqësues nga L.S. ka lidhur kontratë qiraje nr. 941.prot., datë 12.02.2012 pa noter, me ish-Komunën Rrajcë, për kërkim zbulim kromi në fondin pyjor/kullosor publik në pronësi të ish-Komunës Rrajcë (sot Njësia Administrative Rrajcë) prej 10000 m² ose 1 ha dhe jo për 29 ha sipas lejes së shfrytëzimit, me vlerë qiraje të pallogaritur për vlerën 2,734,000 lekë.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas nëpërmjet Njesisë Administrative Rrajcë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **4,243,600 lekë**, duke ndryshuar në kontratë vlerën e qirasë sipas dispozitave të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, konkretisht për subjektet: “” me vlerë 1,509,600 lekë dhe “” me vlerë qiraje të pa llogaritur prej 2,734,000 lekë.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Qukës ka lidhur 2 kontrata për sipërfaqe pyjore/kullosore, të cilat shfrytëzohen nga subjektet private. Tarifa e qirasë së këtyre kontratave nuk është sipas VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave” lidhja 2, duke mos llogaritur diferencën në vlerën 548,479 lekë, me dëm ekonomik në buxhet, konkretisht:

- Subjekti “” shpk, me përfaqësues ligjore z. Q.P. ka lidhur kontratë qiraje datë 18.11.2010 (pa noter) me ish-Komunën Qukës për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të ish-Komunës Qukës (sot Njësia Administrative Qukës) prej 15675 m², me vlerë qiraje të pa llogaritur për vlerën 341,679 lekë.

- Subjekti “” shpk me përfaqësues ligjore z. RR.T. ka lidhur kontratë qiraje nr. 312 prot., datë 18.04.2012 (pa noter) me ish-Komunën Qukës përfaqësuar për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të ish-Komunës Qukës (sot Njësia Administrative Qukës) prej 0.55 ha, vlera e kontratës është llogaritur sipas lidhja 2, pika 9/5 në fakt vlera e kontratës duhej llogaritur sipas lidhjes 2, pika 14/1, vlera e qirasë së pa llogaritur është për shumën 206,800 lekë.

7.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas nëpërmjet Njesisë Administrative Qukës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **548,479 lekë**, duke ndryshuar në kontratë vlerën e qirasë sipas dispozitave të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, konkretisht për subjektet: “” me vlerë 341,679 lekë dhe “”, me vlerë 206,800 lekë.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Qukës ka lidhur kontratë me kompanitë celulare AMC me nr. 803, datë 24.9.2012 për sipërfaqen 300 m² me vlerë tarifë vjetore 305,500 lekë, për vendosjen e antenave dhe gjeneratorëve. Nga të dhënat e marra në sektorin e financës, rezulton se kompania celulare nuk ka likuiduar akoma detyrimet e periudhës 24.9.2014-23.3.2015, gjithsej në vlerën 151,750 lekë, e ardhur e munguar me dëm në buxhet.

8.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas nëpërmjet Njesisë Administrative Qukës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **151,750 lekë**, nga kompania “”.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa më tepër për shpenzime për telefoninë celulare në dispozicion të ish-Kryetarit Bashkisë Përrenjas dhe Ish-Kryetarit të Ish-Komunës Rrajcë në kundërshtim me pikën 9 dhe 11 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për Pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 276,469 lekë.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **276,469 lekë** të përfituar padrejtësisht, e ndarë përkatësisht: nga Ish-Kryetari i Bashkisë z. B.K. në shumën 216,469 lekë dhe nga Ish-Kryetari i Ish-Komunës Rrajcë z. H.Ç. në shumën 60,000 lekë.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Me urdhër-shpenzimin nr. 440, datë 23.10.2014 në shumën 50,240 lekë nga Bashkia Përrenjas është kryer pagesa për blerje materiale mirëmbajtje elektrike për Shtëpinë e Kulturës, të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinë, pasi nuk është prerë fletë-hyrje e për rrjedhojë nuk është prerë dhe fletë dalje, duke mos lënë asnjë gjurmë për lëvizjen e këtyre mallrave (aktiveve) në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e asetëve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve” pika 35, 36, 37, me pasojë dëmin ekonomik në shumën 50,240 lekë.

10.1.Rekomandimi: Bashkia Përrenjas të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **50,240 lekë** nga z. B.K. ish-Përgjegjës i Zyrës së Financës në

cilësinë e nëpunësi zbatues që ka kryer pagesën dhe kontabilizuar në mungesë të dokumentacionit të magazinës.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Prrrenjas dhe Ish-komunat Rrajcë, Qukës dhe Stravaj janë kryer pagesa për shpërblimin e Këshilltarëve për çdo muaj mbi bazën e listprezencave të pjesëmarrjes së këshilltarëve në mbledhje të hartuara nga Kryetarët e Këshillave të dërguara pranë Sektorit të Financës. Nga verifikimi i protokollit të mbajtur nga Sekretarët e Këshillave për çdo mbledhje të realizuar rezultoi se, prezenca e këshilltarëve në mbledhje për muajt përkatës, ku janë zhvilluar mbledhjet nuk përkon me listprezencat e dorëzuara. Gjithashtu u konstatuan që jo në të gjithë muajt janë zhvilluar mbledhje si dhe ka patur mungesa të pjesëmarrjes në mbledhjet e zhvilluara të këshilltarëve të ndryshëm, të cilëve u është paguar shpërblimi padrejtësisht për këto muaj, ku për Bashkinë Përrenjas në shumën 1,351,070 lekë, për ish-Komunën Qukës në shumën 1,369,477 lekë, për ish-komunën Rrajcë në shumën 918,608 lekë dhe për ish-Komunën Stravaj në shumën 819,213 lekë. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2; neni 31, pika 2 dhe pika 8, me pasojë dëmin ekonomik në shumën 4,458,388 lekë (për vitin 2014 në shumën 3,113,209 dhe për vitin 2015 në shumën 1,345,179 lekë).

11.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin të shumës **4,458,388 lekë** të përfituar padrejtësisht nga Këshilltarët për punë të pakryer, ku nga këto: këshilltarët e Bashkisë Përrenjas në shumën 1,351,070 lekë, këshilltarët e ish-Komunës Qukës në shumën 1,369,497 lekë, këshilltarët e ish-Komunës Rrajcë në shumën 918,608 lekë, këshilltarët e ish-Komunës Stravaj në shumën 819,213 lekë sipas shumave përkatëse të përlllogaritura për çdo këshilltar sipas pjesëmarrjeve në mbledhje në çdo muaj të paraqitur në aneksin nr. 6 të Raportit Përfundimtar.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Janë bërë pagesa për shpenzim udhëtim e dieta për punonjësit e administratës dhe Kryetarin në total 2,521,000 lekë, ku për vitin 2014 në shumën 1,600,500 lekë dhe për vitin 2015 në shumën 1,002,500 lekë. Nga këto: Bashkia Prrrenjas në shumën 817,500 lekë, ish-Komuna Qukës në shumën 1,199,000 lekë, ish-Komuna Rrajcë në shumën 317,000 lekë, ish-Komuna Stravaj në shumën 187,500 lekë. Në të gjitha rastet e pagesave mungon autorizimi paraprak i Titullarit, që përcakton kohën e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimin e argumentuar për punën që do të kryhet, i cili duhet të shoqërohet dhe me dokumentacion justifikues, si shkresa apo imail-e të dërguara, për realizim takimesh, për trajnime, ftesa për organizime të ndryshme etj. Gjithashtu në të gjitha rastet e plotësimit të urdhër-shërbimit nuk ka të përshkruar qëllimin e shërbimit, por përshkruhet me një shprehje të përgjithshme “për probleme pune” pa përcaktuar në mënyrë të argumentuar puna që do të kryhet nga punonjësi sipas pozicionit të punës, çka i bën fiktive këto shpenzime. E gjithë kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” me pasojë dëmin ekonomik në shumën 2,521,000 lekë.

12.1.Rekomandim: Bashkia Përrenjas të marrë masat për kontabilizimin e detyrimit dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin të shumës **2,521,000 lekë** të përfituar padrejtësisht nga punonjësit dhe titullarët nga pagesa për udhëtime e dieta për shërbime fiktive jashtë qendrës së punës, ku nga këto: administrata e Bashkisë Prrrenjas në shumën 817,500 lekë, administrata e ish-Komunës Qukës në shumën 1,199,000 lekë, administrata e ish-Komunës Rrajcë në shumën 317,000 lekë, administrata e ish-Komunës Stravaj në shumën 187,500 lekë sipas shumave përkatëse të përlllogaritura për çdo punonjës të paguar të paraqitur në tabelën në aneksin nr. 1, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Përrenjas janë kryer pagesa në vlerën 365,670 lekë për shpërblim të menjëhershëm mbas largimit nga funksioni apo detyra në masën e dy pagave mujore për tre ish-Kryetarët e Komunave në bazë të VKB nr. 32, datë 22.10.2015 të konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Elbasan me shkresën nr. 3774/1, datë 2.11.2015. Shpërblimet e

menjëhershme deri në tre paga me rastin e largimit nga funksioni sipas dispozitave ligjore në fuqi i përfitojnë personat që janë kontribues të fondit suplementar të sigurimit. Në kategoritë e kontribuesve dhe përfituesve të përcaktuar sipas ligjit për pensionet suplementare dhe VKM në zbatim të tij nuk përfshihen Kryetarët e Komunave, të cilët në fakt nuk janë as kontribues të pensionit suplementar. Pagesa e këtyre shpërblimeve është në kundërshtim me ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit “ i ndryshuar neni 1 pika 5, pika 8 germa (b) pika 9 nënpika (a), Kreu II neni7 “pagesa Kalimtare” paragrafi (2) dhe me VKM nr. 382 datë 20.05.1996 “Për zbatimin e ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit" në zbatim të ligjit, Kreu IV, V, VI, VII me pasojë dëmin ekonomik në shumën 365,670 lekë.

13.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin të shumës prej **365,670 lekë** të përfituar padrejtësisht nga shpërblimi i menjëhershëm me 2 paga për largim nga funksioni për tre ish-Kryetarët e Komunave e ndarë përkatësisht: vlera prej 135,150 lekë nga z. F.K. ish-Kryetar i ish-Komunës Qukës, vlera prej 135,150 lekë nga z. H.Ç. ish-Kryetar i ish-Komunës Rrajcë dhe vlera prej 95,370 lekë nga z. A.Z. ish-Kryetar i ish-Komunës Stravaj.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me detyrimet për taksat e ndikimit në infrastrukturë rezultojnë se leja zhvillimore për objektin “Linjë përpunimi qumështi” me investitor E.A. në Qukës, është miratuar nga ish-Komuna Qukës me nr. 363, datë 30.06.2015 sipas Vendimit të ish-Kryetarit Komunës Qukës me nr. 01, datë 30.06.2015, e konfirmuar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit me nr. 366, datë 03.07.2016, në periudhën tranzitore të shkrirjes së ish-Komunës Qukës me Bashkinë e re, Përrenjas dhe nuk është llogaritur dhe arkëtuar as nga ish-Komuna Qukës dhe as nga Bashkia Përrenjas, përpara dorëzimit të lejes së ndërtimit, Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë, për sipërfaqen e ndërtimit, sipas lejes së miratuar, prej 762 m². Vlera totale e ndërtimit, sipas kostos së ndërtimit për vitin 2014, e miratuar me UKM nr. 2, datë 06.08.2014, për Përrenjasin=32,595 lekë/m², është (762 m² x 32,595 lekë/m²) = **24,837,390 lekë**. Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ish-Komunën Qukës është vendosur në masën 2% të vlerës totale të ndërtimit të objektit për kategorinë biznes, për vitin 2015, me VKK nr. 01, datë 09.02.2015 dhe në këto kushte subjekti E.A. për lejen e ndërtimit të marrë, duhet të paguante në ish-Komunën Qukës ose në Bashkinë e re Përrenjas, taksën e ndikimit në infrastrukturë në shumën prej 24,837,390 lekë x 2% = 496,748 lekë.

14.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin të shumës prej **496,748 lekë**, nga z. E.A. Qukës, detyrim i pa llogaritur dhe i pa arkëtuar, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për lejen e ndërtimit nr. 363, datë 30.06.2015 sipas Vendimit të ish-Kryetarit Komunës, Qukës me nr. 01, datë 30.06.2015 me objekt “Linjë përpunimi qumështi”.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të fondeve me objekt “Rikonstrukcion shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” Pishkash, Komuna Qukës”, nga KVO është skualifikuar pa të drejtë, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi për prokurimin publik, operatori ekonomik “██████████” shpk, me ofertë ekonomike 5,788,650 lekë, pa tvsh, me argumentin “Vërtetimi i CEZ për pagesën e energjisë nuk është i rregullt pasi është paguar deri në datën 31.07.2014 duke lënë pa paguar faturën e muajit qershor, korrik 2014. Bazuar në VKM nr. 379, datë 11.06.2014 për disa shtesa në Vendimin nr. 1 datë 10.01.2007 të Ministrave “Për miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” të ndryshuar pika 1a) përcakton se mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit. Për këtë arsye ju skualifikoheni”. Në procesverbal argumentohet se “Vërtetimi i dorëzuar deklaroi se operatori është debitor për muajt qershor dhe korrik, 2014”. Nga auditimi rezultoi se operatori “██████████” shpk, me ofertë ekonomike 5,788,650 lekë, pa tvsh, ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Tiranë me nr. 1990, datë 31.07.2014 ku vërtetoi se “..për kërkuesin ██████████ përfaqësuar nga znj. Sh.N. pas verifikimeve të kryera në Sistemin e

Faturimit, titullar i të cilave është NIKA, rezulton të ketë në total 0.00 lekë (zero) detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 31.07.2014, pa përfshirë faturën koherente të muajit QER 2014”. KVO e ka skualifikuar në mënyrë të kundraligjshme operatorin “██████████” shpk pasi vërtetimi sa më sipër tregon që operatori ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, argumenti i KVO për detyrimet e muajit qershor, korrik 2014 është i kundraligjshëm se ato përbëjnë detyrime të pamaturuara të energjisë elektrike, të evidentuara për muajin qershor dhe në vërtetimin, sa më sipër. Veprimet e KVO sa më sipër mbi vendimin e saj për skualifikimin e operatorit me ofertën më të ulët në tender “██████████” shpk, me ofertë ekonomike 5,788,650 lekë, pa tvsh, janë në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 379, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për Prokurimin Publik” të ndryshuar, të VKM nr. 380, datë 11.06.2014 “Për disa shtesa në VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, si dhe procedurave që lidhen me ndryshimet në rregulloren uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit, miratuar me Vendimin Nr. 502, datë 13.07.2011, i ndryshuar. Vendimi i KVO është marrë në kundërshtim me nenet 1, pika 2, germa d) dhe dh); nenin 2; Kreu III, nenin 20, nenin 53, pika 4, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe për pasojë është shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit në shumën prej 2,203,961 lekë, diferenca e ofertës ekonomike më të ulët, e skualifikuar pa të drejtë, me ofertën e shpallur fituese të tenderit (7,992,611-5,788,650 lekë).

15.1. Rekomandimi: Bashkia Prrenjas të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin të shumës prej **2,203,961 lekë**, nga KVO, ish-Komuna Qukës, i përbërë nga z. E.V. Kryetar, z. S.A. anëtar dhe z. E.K. anëtar pasi në procedurën e prokurimit të fondeve me objekt “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” Pishkash, Komuna Qukës”, ka marrë vendim për skualifikimin në mënyrë të kundraligjshme të ofertës me vlerë më të ulët në shumën 2,203,961 lekë nga oferta e shpallur fituese në mënyrë të kundraligjshme.

Menjëherë

B2. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, të ish-Komunave Rrajcë, dhe Qukës, u konstatua se kryejnë aktivitet shfrytëzim karriere 11 subjekte, të cilët kanë në përdorim sipërfaqe pyjore/kullosore të shfrytëzueshme, gjithsej prej 424.39 ha. Për këto subjekte nuk janë lidhur kontrata qiraje për sipërfaqet që ato kanë në përdorim, për llogaritjen dhe pagesën e qirasë, sipërfaqe të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi/përdorim të këtyre Njësive Vendore, duke sjellë një mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetet e tyre për vlerën 383,746,864 lekë, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9791, datë 23.07.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar me ligjin nr. 9533, datë 15.05.2006, neni 38, germa “q” dhe nenin 40/1-Vlerësimi i dëmit, pika 1 dhe 2, VKM nr. 22, datë 09.01.2008” Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të administrimit të pyllit komunal”, pika 4,6 dhe 11, VKM nr. 391, datë 21.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja 2, si dhe me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas në bashkëpunim Njësitë Administrative Qukës, Rrajcë dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke lidhur kontrata qiraje, para noterit publik, në përputhje me nenin 39 germa f, nenet 40, 54, 56, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe pikat 3, 4, 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, të ndryshuar, duke përcaktuar dhe arkëtuar detyrimet për qiranë në vlerën **383,746,864 lekë**, respektivisht:

- Subjekti “██████████” shpk për sipërfaqen 25.4 ha me vlerë 13,581,334 lekë ,
- Subjekti “██████████” shpk për sipërfaqe n 51.95 ha me vlerë 45,716,000 lekë,
- Subjekti “██████████” shpk për sipërfaqen 166 ha me vlerë 146,080,000 lekë,
- Subjekti “██████████” shpk për sipërfaqen 3.2 ha me vlerën 2,816,000 lekë,

- Subjekti “ [REDACTED] ” shpk për sipërfaqen 30 ha me vlerën 26,400,000 lekë,
- Subjekti “ [REDACTED] ” shpk për sipërfaqen 130.4 ha me vlerën 114,752,000 lekë,
- Subjekti “ [REDACTED] ” shpk për sipërfaqen 3.3 ha me vlerën 2,299,000 lekë,
- Subjekti “ [REDACTED] ” shpk për sipërfaqen 2.6 ha me vlerën 1,144,000 lekë,
- Subjekti “ [REDACTED] ” shpk për sipërfaqen 23 ha me vlerën 20,240,000 lekë,
- Subjekti “ [REDACTED] ” shpk për sipërfaqen 12.4 ha me vlerën 9,093,330 lekë,
- Subjekti “ [REDACTED] ” shpk për sipërfaqen 1.54 ha me vlerën 1,355,200 lekë

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 141 dhe neni 153 pika 1, 2 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, t’i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Përrenjas, që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore:

“Zgjidhjen e kontratës së punës”, për:

1. Z. E.V. Kryetar i KVO, ish-Komuna Qukës.

2. Z. S.A. anëtar i KVO, ish-Komuna Qukës.

3. Z. E.K. anëtar i KVO, ish-Komuna Qukës.

Për shkeljet në tenderin me objekt “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” Pishkash, Komuna Qukës” zhvilluar më 15.09.2014, me fondin limit pa tvsh 8,086,598 lekë, shpallur fitues “ [REDACTED] ” shpk & “ [REDACTED] ” shpk, me ofertë 7,992,611 lekë pa tvsh. (oferta fituese e shpallur në sistem është 7,612,010 lekë), me vlerën e kontratës me tvsh 9,591,133 lekë. Në tender janë paraqitur BO “ [REDACTED] ” shpk & “ [REDACTED] ” shpk me ofertën ekonomike 7,992,611 lekë, pa tvsh dhe “ [REDACTED] ” shpk, me ofertë ekonomike 5,788,650 lekë, pa tvsh. Në bazë të procesverbalit të KVO, të datës 05.09.2014, nga KVO është skualifikuar pa të drejtë, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi për prokurimin publik, operatori ekonomik “ [REDACTED] ” shpk, me ofertë ekonomike 5,788,650 lekë, pa tvsh, me argumentin “Vertetimi i Cez per pagesen e energjise nuk është i rregullt pasi është paguar deri ne datën 31.07.2014 duke lene pa paguar faturen e muajit qershor, korrik 2014. Bazuar ne VKM nr. 379, date 11.06.2014 "Per miratimin e Rregullave per Prokurimin Publik" te ndryshuar pika 1a) percakton se mos shlyerja e detyrimeve te energjise elektrike perben shkak per skualifikimin e operatorit. Per kete arsye ju skualifikoheni”. Në procesverbal argumentohet se “Vërtetimi i dorëzuar deklaroi se operatori është debitor për muajt qershor dhe korrik, 2014.

Nga auditimi rezultoi se operatori “ [REDACTED] ” shpk, me ofertë ekonomike 5,788,650 lekë, pa tvsh, ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Tiranë me nr. 1990, datë 31.07.2014 ku vërtetoi se “..për kërkuesin [REDACTED] përfaqësuar nga znj. Sh.N. pas verifikimeve të kryera në Sistemin e Faturimit, titullar i të cilave është NIKA, rezultoi të ketë në total 0.00 lekë (zero) detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 31.07.2014, pa përfshirë faturën koherente të muajit QER 2014.

KVO e ka skualifikuar në mënyrë të kundraligjshme operatorin “ [REDACTED] ” shpk pasi vërtetimi sa më sipër tregon që operatori ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, argumenti i KVO për detyrimet e muajit qershor, korrik 2014 është i kundraligjshëm se ato përbëjnë detyrime të pamaturuara të energjisë elektrike, të evidentuara për muajin qershor dhe në vërtetimin, sa më sipër.

Veprimet e KVO sa më sipër mbi vendimin e saj për skualifikimin e operatorit me ofertën më të ulët në tender “ [REDACTED] ” shpk, me ofertë ekonomike 5,788,650 lekë, pa tvsh, janë në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 379, datë 11.06.2014 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave për Prokurimin Publik” të ndryshuar, të VKM nr. 380, datë 11.06.2014 “Për disa shtesa në VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, si dhe procedurave që lidhen me ndryshimet në rregulloren uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit, miratuar me Vendimin Nr. 502, datë 13.07.2011, i ndryshuar, ku përcaktohet “Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mos shlyerja e detyrimeve të energjisë

elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.

Vendimi i KVO është marrë në kundërshtim me nenet 1, pika 2, germa d) dhe dh); nenin 2; Kreu III, nenin 20, nenin 53, pika 4, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe për pasojë është shkaktuar **dëm ekonomik buxhetit të shtetit në shumën prej 2,203,961 lekë**, diferenca e ofertës ekonomike më të ulët, e skualifikuar pa të drejtë, me ofertën e shpallur fituese të tenderit (7,992,611-5,788,650 lekë).

II. Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 11, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore,
“Vërejtje me shkrim”.

Për:

1. Znj. M.K. me detyrë ish Përgjegjëse e Zyrës së Taksave aktualisht specialiste Transporti në Bashkinë Përrenjas, për shkeljet si më poshtë:

Mos ndjekjen e procedurave ligjore për regjistrimin e 11 subjekteve, të cilët kanë shmangur pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 212,917 lekë, me dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me pikën 1 e nenit 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe pikat 1,2,3,4 dhe 5 e nenit 41, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Z. A.G. me detyrë ish Përgjegjëse e Zyrës së Taksave ish Komuna Qukës aktualisht specialiste taksash në Bashkinë Përrenjas, për shkeljet si më poshtë:

Mos ndjekjen e procedurave ligjore për regjistrimin e 16 subjekteve, të cilët kanë shmangur pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 339,400 lekë, me dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me pikën 1 e nenit 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe pikat 1,2,3,4 dhe 5 e nenit 41, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

3. Znj. G.K. me detyrë ish-specialist pyjesh në, ish-Komunën Rrajcë (sot Njësia Administrative Rrajcë e Bashkisë Përrenjas), për shkeljet si më poshtë:

-Mos zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjorë”, të ndryshuar me ligjin nr. 9791, datë 23.7.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjorë”, VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pikave 4 dhe 6, për administrimin e pronave të ish-Komunën Rrajcë, VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave” lidhja 2.

4. Z. Xh.N. me detyrë ish-specialist pyjesh në, ish-Komunën Qukës (sot Njësia Administrative Qukës e Bashkisë Përrenjas), për shkeljet si më poshtë:

-Mos zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjorë”, të ndryshuar me ligjin nr. 9791, datë 23.7.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjorë”, VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pikave 4 dhe 6, për administrimin e pronave të ish-Komunën Rrajcë, VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave” lidhja 2.

III. Mbështetur në nenin 141, 153, 201 dhe 202 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe kontratës individuale të punës, nenet 8 dhe 9, Kryetari i Bashkisë Përrenjas,

të vlerësoj të metat e mangësitë e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore ose administrative sipas shkallës së përgjegjësisë për punonjësit e atakuar në RP të Auditimit për punonjësit e mëposhtëm:

1. Znj. K.K. me detyre ish-Drejtores Financës në ish-Komunën Qukës (për periudhën 01.01.2014-30.06.2015) si dhe Drejtores e Financës dhe Tatim-Taksave në Bashkinë Përrenjas në cilësinë e nëpunësit zbatues (për periudhën 21.09.2015-31-12.2015), aktualisht Përgjegjëse e Zyrës së Financës,

2. Znj. D.Ç. me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit të Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues (për periudhën 01.01.2014-30.06.2015) aktualisht specialiste finance në Drejtorinë e Financës dhe Tatim-Taksave në Bashkinë Përrenjas

Për shkeljet e konstatuara në pagesat e shpenzimeve udhëtim e dieta mbi bazën e dokumentacionit të parregullt mbështetës dhe autorizues, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 45, 46 dhe 47 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalin nr. 1, datë 24.06.2016, vërejtjeve dhe komenteve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit, bazuar në shkronjën “ç” të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 7 pika 2, 3/a të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit publik që, në zbatim të neneve 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për 3 anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të autoritetit kontraktor, Bashkia Përrenjas, si më poshtë:

- 1. M.A.** Kryetar i KVO
- 2. K.K.** anëtar i KVO
- 3. M.H.** anëtar i KVO

Për tenderin me objekt “Blerje dru zjarri për çerdhet, kopshtet dhe shkollat e Bashkisë Përrenjas dhe njërive nën varësi të saj”, zhvilluar në datën 06.11.2015, me fondin limit 3,666,660 pa tvsh, shpallur fitues “██████████” shpk, me ofertë 3,660,000 lekë pa tvsh, me diferencë nga fondi limit 6,660 lekë në bazë të formularit të Kontratës nr. 1394, datë 22.12.2015, me vlerën 3,660,000 lekë pa tvsh.

Në tender ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik “██████████” shpk, me ofertën ekonomike në shumën 3,660,000 lekë, pa tvsh. Nga auditimi u konstatuan të metat dhe mangësitë e mëposhtme:

-Në bazë të procesverbalit të KVO, datë 06.11.2015, KVO është futur në sistem dhe ka konstatuar se është paraqitur në tender vetëm operatori ekonomik “██████████” shpk, me adresë Shkodër, Qafë-Mali, me vlerë ekonomike të ofruar 4,392,000 lekë me tvsh, duhej të reflektohej oferta pa tvsh. Në këtë procesverbal përshkruhet vetëm se dokumentacioni ligjor administrativ është në rregull dhe KVO vendos të propozoj Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të shpall fitues operatorin e vetëm pjesëmarrës “██████████” shpk, me vlerë ekonomike të ofruar 4,392,000 lekë me tvsh. Me Vendimin nr. 6, datë 07.11.2015 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor është miratuar procedura e tenderimit dhe është shpallur fitues shoqëria ██████████ shpk, me vlerë ekonomike të ofruar 4,392,000 lekë me tvsh.

Nga auditimi sa më sipër rezulton se KVO ka kualifikuar, klasifikuar dhe propozuar për fituesin e tenderit operatorin e vetëm pjesëmarrës në tender “██████████” shpk, me vlerë ekonomike të ofruar 4,392,000 lekë me tvsh, në kundërshtim me DST, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, pasi operatori ekonomik nuk përmbush kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit si më poshtë:

DST 2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim dhe nuk ka informacion nëse i ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2015 në organin vendor ku ka selinë kryesore, me adresë kryesore Shkodër, Qafë Mali, Lagjja Bardhet, ka paraqitur vërtetim vetëm për adresën dytësore.

DST 2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik fitues nuk plotëson kriterin sa më sipër pasi nuk ka paraqitur dëshmi për furnizime të ngjashme të kryera gjatë tri viteve të fundit nëpërmjet kontratave me ent publik ose me sektorin privat të shoqëruar me faturë tatimore dhe vërtetim për realizim të suksesshëm të kontratës. Në vend të tyre operatori ekonomik ka paraqitur aktmarrëveshje të cilat nuk janë të shoqëruara me faturë tatimore dhe nuk janë të barasvlershme me dokumentet që kërkohen për tender, të përshkruara në DST pika 2.3 dhe si më sipër.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dhe nuk plotëson kriterin sa më sipër pasi nuk disponon gjithashtu kontratë me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor dhe leje të shfrytëzimit të lëndës drusore nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor si dhe nuk ka paraqitur kontratë shitblerje (të noterizuar) me palën shitëse në rastet kur operatori nuk është drejtpërsëdrejti shfrytëzues i parcelave të lëndës drusore. Aktet që ka paraqitur operatori janë leje transporti për material të përpunuar për ambalazh.

DST 2.1.f Kriteret e veçanta të kualifikimit

Subjekti nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, DST pika 2.1.f, sa më sipër pasi nuk ka paraqitur dhe nuk konfirmon dhe vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik në Shqipëri (përfshi këtu edhe NIPT-et sekondare). Në kushtet sa më sipër, subjekti “XXXXXXXXXX” shpk, me vlerë ekonomike të ofruar 4,392,000 lekë me tvsh duhej të skualifikohej në bazë të nenit 46 Kualifikimi i ofertuesve, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” ndryshuar për mosplotësim të kërkesave dhe kriterëve të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe themelore për realizimin e saj dhe tenderi duhet të anulohet pasi ishte paraqitur vetëm një operator ekonomik dhe mund të aplikohet lloji i procedurës me negociim pasi ky tender kishte dështuar dhe njëherë më përpara.

Veprimet sa më sipër kanë sjellë për pasojë përfitimin nga operatori ekonomik “GJINI” shpk të kontratës pothuajse në vlerë të barabartë me fondin limit, me një diferencë të papërfillshme prej 6,660 lekë, në kundërshtim me nenet 5, 21 dhe 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenet 1, pika 2; neni 24, pika 1, germa ç; neni 53, pika 3, 4 dhe neni 58 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” ndryshuar, dhe, në bazë të nenit 1 të VKM dhe nenit 12 të ligjit, të cituar më sipër, dhe trajtuara në Procesverbalin nr. 1, datë 24.06.2016.

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për 3 punonjës të Ish-Komunës, Qukës:

1. Z. E.V. me cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

2. Z. S.A. me cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

3. Z. E.K. me cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

pasi në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” Pishkash, Komuna Qukës” kanë kryer veprime të kundërligjshme të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 dhe neni 258 i Kodit Penal, mbartin elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, me dëm ekonomik në vlerën 2,203,961 lekë.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Shënim: Për punonjësit e larguar nga puna: z. B.K. në funksionin e ish-Kryetarit të Bashkisë Përrenjas, z. B.K. me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Financës në Bashkinë Përrenjas, z. H.C. në funksionin e ish-Kryetarit të Komunës Rrajcë, z. F.K. në funksionin e ish-Kryetarit të Komunës Qukës, z. A.Z. në funksionin e ish-Kryetarit të Komunës Stravaj, z. Sh.N. në funksionin e ish-Kryetarit të Këshillit Bashkiak Përrenjas, z. K.G. në funksionin e ish-Kryetarit të Këshillit të ish-Komunës Qukës, z. M.H. në funksionin e ish-Kryetarit të Këshillit të ish-Komunës Rrajcë, z. L.Ç. me detyrë ish-Sekretari i Këshillit të Komunës Stravaj, zj. J.Zh. me detyrë ish-Specialiste Buxhetit në Bashkinë Përrenjas, z. A.B. me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit të Financës në ish-Komunën Stravaj dhe z. J.V. me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Taksave në Komunën Stravaj, nuk rekomandohet masë disiplinore pasi kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me institucionin dhe nuk kanë adresim institucional.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Drejtoria Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R